



SHËRBIMI "RESPITE CARE"

Ky program i jep familjes mundësi të lirohet përkohësisht nga përkujdesja e vazhdueshme për personin me aftësi të kufizuara në mënyrë që të realizojë funksionet e saj. Studimet kanë treguar se kjo është mbështetja më e mirë që ndihmon në realizimin e "normalizimit" për familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara. Shërbimet "Respite" reduktojnë stresin e familjes, ndihmojnë në mirëfunksionimin e saj dhe mbështesin stabilitetin. Një qendër e specializuar ofron shërbime përkujdesi nga një orë deri në dy javë. Mjedisi i qendrës është shumë i ngjashëm me atë të shtëpisë. Shërbimet ofrohen sipas grupmoshave, për fëmijë dhe të rritur; Gjatë kohës në qendër, individët marrin pjesë në aktivitete pune, edukative dhe zbatimëse në përputhje me dëshirat dhe mundësitë e tyre. Shërbimi "Respite care" mund të ofrohet edhe në shtëpi. Një koordinator interviston dhe bën verifikimin e historisë penale të individëve që kanë dëshirë të punojnë me individë me aftësi të kufizuara në shtëpitë e këtyre të fundit. Aplikantët që shihen si të përshtatshëm i rekomandohen familjeve që e kanë kërkuar këtë shërbim. Familjet, pasi zgjedhin aplikantët që u duken më të përshtatshëm, bëjnë punësimin e tyre sipas nevojave. Avantazhi i kësaj forme, është që individi me aftësi të kufizuara nuk largohet nga mjedisi që njeh. Kujdesi mund të ofrohet nga disa orë deri në një javë.

SHËRBIMI I TRANSPORTIT TË PËRSHTATUR

Ky shërbim synon ofrimin e transportit të përshtatur në ndihmë të individëve me aftësi të kufizuara për ndjekjen e aktiviteteve të përditshme si në ambientin e punës apo në aktivitete të ndryshme në komunitet. Ky shërbim mund të sigurohet nëpërmjet blerjes të një ose disa mjeteve të përshtatura të transportit publik nga Bashkia, apo duke kontraktuar mjete të përshtatura nga qendra apo operatorë privatë që kanë në pronësi mjete të përshtatura transporti në plotësim të nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Sigurimi i këtij shërbimi do të zgjidhte nevojat në rradhë të parë të qendrave publike që janë në varësi të Bashkisë, por nga ana tjetër do të zgjidhte edhe problemet që paraqesin personat me aftësi të kufizuara të cilët banojnë në zonat periferike, ku janë më së shumti të lokalizuara rastet më të rënduara dhe të izoluar.

TEKNOLOGJI ASISTIVE DHE MJETE NDIHMËSE PËR LËVIZJE

Shërbimi i ofrimit të karrigeve me rrota ka në themel të tij procesin e vlerësimit të nevojave specifike, si fizike ashtu edhe shëndetësore të individëve të cilët do të pajisen me këtë mjet. Kjo, pasi vlerësimi i detajuar sipas standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë u mundëson specialistëve të përshtasin karrigen me rrota në përputhje me specifikat e individëve me aftësi të kufizuara. Kriteri themelor i këtij shërbimi është që duhet t'u ofrohet individëve me aftësi të kufizuara vetëm nga specialistë të çertifikuar për procesin e vlerësimit. Vlerësimi është një proces i një konsultimi të përbashkët ndërmjet personit me aftësi të kufizuara dhe personelit të shërbimit, qëllimi është që të ndihmohet përdoruesi për të zgjedhur produktin e duhur. Rezultati është shpesh një përkrahim i detajuar, që përcakton karakteristikat e karrigës më të përshtatshme për personin në nevojë.

Ofrimi i karrigës. Pas procesit të vlerësimit, ofruesit e shërbimit sigurojnë karrigen e duhur me rrota. Ky proces përfshin porositjen, montimin nëse është i nevojshëm, si edhe përshtatjen e pajisjes.

Trajnimi. Me qëllim që përdoruesi të ketë përfitim maksimal nga karrigia me rrota, ofruesit e shërbimit i ofrojnë atyre dhe kujdestarëve të tyre trajnim se si të mirëmbajnë karrigen dhe se si ta përdorin atë efektivisht.

Mbështetja. Për të gjithë përdoruesit, shërbimet ofrojnë mbështetje të vazhdueshme klinike dhe teknike. Kjo përfshin ofrimin e këshillimit për kujdes shëndetësor, shmangien e presionit të gjakut dhe komplikacioneve, deformimeve të tjera si edhe shërbime riparimi dhe ndjekje të rasteve.

Referimi. Kur duhet, shërbimet do t'i referojnë përdoruesit në shërbime të tjera që mund të jenë me interes për ta.



SHËRBIMI I PUNËSIMIT ME MBËSHTETJE:

Modeli i Punësimit të Mbështetur për personat me aftësi të kufizuara konsiston në disa faza:

- 1 Faza e orientimit / trajnimit për aftësi që lidhen me përgatitjen për tregun e punës, përmes angazhimit dhe ndërveprimit me personin me aftësi të kufizuara;
- 2 Profilitizimi profesional, përmes vetëvlerësimit dhe vlerësimit nga punonjësit mbështetës/ këshilluesit për punësimin;
- 3 Ndërmjetësimi për punësim dhe gjetja e punës;
- 4 Angazhimi i punëdhënësit - vlerësimi i ambientit dhe procesit të punës, i rregullores së punës, vendosjes në proces pune bazuar në përvojën apo aftësitë për punë;
- 5 Ndhimë / Ndjekje gjatë fazës së punësimit - mbështetje në fazën e hyrjes/ vendosjes në një pozicion pune, për zhvillimin profesional dhe integrimin personal, mbështetje e vazhdueshme. Këtu përfshihen edhe elemente si kombinimi i punësimit dhe trajnimit në vendin e punës, por edhe realizimi i praktikave bashkuar me përshtatjen në vendin e punës, ofrimi i asistentit personal (ekspert i brendshëm ose i jashtëm), dhe akomodime të tjera të arsyeshme etj.
- 6 Coach/ këshillues dhe mbikqyrës - monitorim afatgjatë (këshillimi / orientimi profesional / kontakte me punëdhënësit / personi i kontaktit në situata konflikti etj.

Shërbime të parandalimit e rehabilitimit realizohet përmes: ● zgjerimit së Fizioterapisë; ● ngritjes së Qendrës Komunitare të Shëndetit Mentor⁸ ● përfshirjes së trajtimit të specializuar për fëmijët me aftësi të kufizuara në paketën bazë të shërbimeve;

⁸ Referoju Ligjit për Shëndetin Mentor

SHËRBIMI I PROTEZIMIT, ORTEZIMIT, REHABILITIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Shërbimi i protezimit, ortezimit, rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuara ofrohet çdo 3 (tre) vjet për personat me aftësi të kufizuara dhe përfshin prodhimin e protezave për gjymtyrët e sipërme dhe të poshtme, orteza për deformimin e këmbëve dhe shtyllës kurrizore, rehabilitim të personave që kanë bërë amputim, si edhe trajtim psikologjik për personat me aftësi të kufizuara duke i motivuar që të integrohen në shoqëri.



Ky material është përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK), në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të Mos Mbetet Pas/Leave No One Behind" (LNB), i cili zbatohet në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare dhe mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

TË DHËNA MBI DISA OFRUES SHËRBIMESH PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHQIPËRI

OFRUESI I SHËRBIMIT	EMRI I SHËRBIMIT	BASHKIA KU OFROHET SHËRBIMI
Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK)	Qendër burimore informimi për aftësinë e kufizuar	Tiranë Adresa: Rruga e Bogdanëve, Nr. 19, Tiranë; Telefon: +355 4 2269426; Email: info@adrf.al; Webpage: www.adrf.al
Shoqata "Ndhmoni Jetën"	Ndërhyrja e hershme	Tiranë Adresa: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë; Telefon: +355 (0)682084945; Email: info@helpthelife.org.al; Webpage: www.helpthelife.org
Down Syndrome Albania	Ndërhyrja e hershme	Tiranë Adresa: Rruga Hajredin Kumbo, Sauk, Tiranë; Telefon: +355 (0) 68 804 2222; Cel: +355 (0) 692325874; Email: f.shehu@dsalbania.org; Webpage: www.dsalbania.org
Down Syndrome Albania	Terapi zhvillimi për persona me aftësi të kufizuara me sindromën doën dhe me çrregullime të spektrit të autizmit	Tiranë Adresa: Rruga Hajredin Kumbo, Sauk, Tiranë; Telefon: +355 (0) 68 804 2222; Cel: +355 (0) 692325874; Email: f.shehu@dsalbania.org; Webpage: www.dsalbania.org
Qendra Jonathan	Terapi zhvillimi për persona me aftësi të kufizuara me sindromën doën	Tiranë Adresa: Rruga e Kavajës, Nr. 175, Tiranë; Telefon: +355 (0) 688344123; Cel: +355 (0) 693230783; Email: info@downsyndromealbania.com; Webpage: www.downsyndromealbania.com
World Vision, Albania	Tungjatjeta jetë - Shërbime në familje	Librazhd, Dibër, Bulqizë, Prrenjas, Lezhë, Rrogozhinë Adresa: Rruga Skënderbej, Ndërtesa Gurten, Kati 2, Tiranë; Telefon: + 35590) 42419601 e-mail: info@tungjatjeta.al; Webpage: www.tungjatjeta.al; www.worldvision.al
Bashkia Lushnje	Qendër ditore multifunkionale	Lushnje Adresa: Lagja "Xhevdet Npravishta", pranë spitalit "Insan Çabej"; Telefon: +355 (0) 696271784/(0) 699763888; Email: bashkia_lushnje@yahoo.com; qendrazhvillimitlushnje@gmail.com; www.bashkialushnje.gov.al; Facebook: Qendra e Zhvillimit Lushnje

TË DHËNA MBI DISA OFRUES SHËRBIMESH PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHQIPËRI

OFRUESI I SHËRBIMIT	EMRI I SHËRBIMIT	BASHKIA KU OFROHET SHËRBIMI
Bashkia Pogradec	Qendër komunitare për personat me aftësi të kufizuara	Pogradec Adresa: Lagja 3, Rruga "Jovan Basho", Pogradec; Telefon: + 355 (0) 672640760; Email: anilabebr@yahoo.com; qendraspeciale@gmail.com; Facebook: Qendra Speciale Pogradec
Fondacioni "OAZ" Burrel	Qendra ditore "SHPRESA E RE"	Burrel Adresa: Lagja "Pjeter Budi"/ Rruga "Ahmet Xhetani" nr.14, Burrel; Telefon: +355 (0) 692156500; Email: sajmimeziri@hotmail.com
Bashkia Fier	Qendër Multifunkionale "Horizont"	Fier Adresa: Rruga Lukan Toska, L. 16 Prilli, Fier; Telefon: Drejtoria: +355 693352462, Sekretaria: +355 698154769; Email: qendrapakheral@gmail.com
Opera della Divina Provvidenza Madonna del Grappa, Shkodër	Shtëpi familje rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike	Shkodër Adresa: Rruga "Marin Bicikemi", Shkodër; Telefon: +355672862161; 022242684; Email: fabrizionocchi@gmail.com
Shoqata " Ndhmoni Jetën"	Jetesë e pavarur në komunitet për personat me aftësi të kufizuara intelektuale	Tiranë Adresa: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë - Shqipëri; Telefon: +355(0)682084945; Email: info@helpthelife.org.al
Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK)	Shërbimi i mjeteve ndihmëse për lëvizje	Tiranë (mbulon nevojat në gjithë Shqipërinë) Adresa: Rruga e Bogdanëve, Nr. 19, Tiranë; Telefon: +355 4 2269426; Email: info@adrf.al; Webpage:www.adrf.al
Qendra Drita e Shpresës	Shërbimi i protezimit, ortezimit, rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuara	Pogradec Adresa: Rruga Nehemia 122, 7304 Pogradec; Telefon: +355 (0) 83 22 69 41, 0696029724; Email: qendra@drita-al.org; Webpage: www.drita-e-shpreses-al.org
Shoqata Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara "Shpresa për Jetën"	Shërbimi i protezimit, ortezimit, rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuara	Tiranë Adresa: Rruga Jordan Misja/Osman Jonuzi Nr. 54, Tiranë; Telefon: +355682289253 E-mail: izetonuzi@hotmail.com; Facebook: Shpresa per Jeten
Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK)	Shërbime mbështetëse punësimi	Tiranë Adresa: Rruga e Bogdanëve, Nr. 19, Tiranë; Telefon: +355 4 2269426; Email: info@adrf.al; webpage: www.adrf.al



MODELE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA



Leave No One Behind



Ofrimi i shërbimeve shoqërore, të cilat duhet të përbushin nevojat e personave me aftësi të kufizuara, është një detyrim ligjor, i cili rrjedh nga Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë¹, Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë², Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuara³ dhe Dokumenti Politik i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar⁴.

Shërbimet e bazuara në komunitet nuk janë gjë tjetër veçse një sërë shërbimesh mbështetëse që i nevojiten një personi për të kapërcyer barrierat, për të jetuar jetën e tij/saj dhe për t'u përfshirë plotësisht në shoqëri.

Ndërhyrjet, për të garantuar shërbime shoqërore për personat me aftësi të kufizuara, duhet të fokusohen në:


- 1 mbështetjen e shërbimeve ekzistuese në territor;
- 2 rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve vendore rreth përgjegjësisë së krijimit dhe mbështetjes/mbajtjes së shërbimeve komunitare për personat me aftësi të kufizuara;
- 3 vlerësimin e nevojave për shërbime të ndryshme për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara dhe të gjitha grupmoshat;
- 4 dizajnimin e shërbimeve të jetesës së pavarur në komunitet, në mënyrë të veçantë për persona madhorë me aftësi të kufizuara mendore, përfshirë këtu edhe shërbimin e punësimit me mbështetje të të rinjve me aftësi të kufizuara;
- 5 funksionimin e shërbimit të asistencës në familje;
- 6 ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të transportit të përshtatur;
- 7 ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të informimit, këshillimit dhe fuqizimit për persona me aftësi të kufizuara dhe prindër apo familjarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 8 ngritjen e shërbimeve të zhvillimit dhe rehabilitimit për persona me aftësi të kufizuara, fëmijë me aftësi të kufizuara, përfshirë të gjitha terapitë e zhvillimit, fizioterapi, logopedi, terapi okupacionale, mbështetje psikologjike etj;
- 9 identifikimin dhe rritjen në vazhdimësi të kapaciteteve të specialistëve apo organizatave që do të drejtojnë dhe zbatojnë këto shërbime;

- 1 SHËRBIME TË INFORMIMIT, ORIENTIMIT, FUQIZIMIT
- 2 NDËRHYRJA E HERSHME
- 3 SHËRBIME TERAPEUTIKE
- 4 SHËRBIME TË Pjesëmarrjes në Komunitet
- 5 SHËRBIME NË FAMILJE/SHËRBIMI I ASISTENCËS NË SHTËPI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ZONA TË LARGËTA
- 6 QENDRA DITORE MULTIFUNKSIONALE
- 7 SHËRBIME TË JETESËS SË PAVARUR
- 8 SHËRBIMI I TRANSPORTIT TË PËRSHTATUR
- 9 SHËRBIMI "RESPITE CARE"
- 10 TEKNOLOGJI ASISTIVE DHE MJETE NDIHMËSE PËR LËVIZJE
- 11 SHËRBIMI I PUNËSIMIT ME MBËSHTETJE

Burimet e financimit për ngritjen e shërbimeve duhet të jenë një kombinim i fondeve të akorduara nga pushteti qendror, në përputhje me strategjitë dhe planet e veprimit të miratuara në MSHMS⁵, si edhe atyre që duhet të planifikohen nga vetë institucionet vendore, përmes aplikimit të Fondit Social⁶. Ligji nr. 121, datë 21.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij rregullojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në mënyrë të posaçme procesin e ofrimit të shërbimeve nga organet publike në nivel vendor të ngarkuara sipas Ligjit. "Shporta" e shërbimeve të kujdesit shoqëror, përmban disa shërbime, nga aplikimi i të cilave përfiton komuniteti i personave me aftësi të kufizuara. Këto shërbime ofrohen sikurse parashikohet edhe në Ligjin nr 21, datë 21.11.2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" nga personat juridikë publikë apo jopublikë, të licencuar për këtë qëllim. Licencimi i veprimtarive të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe subjekteve të ofrimit të tyre, bëhet nga autoriteti përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për licencat. Shërbimet e kujdesit shoqëror të financuara privatisht ofrohen nga subjekte jopublike, por sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Në këtë paketë, gjeni disa shërbime bazë, të cilat duhet të ngrihen e të jenë të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara sa më pranë komuniteteve ku ata jetojnë nga.

QENDËR INFORMUESE, ORIENTUESE E KËSHILLUESE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE FAMILJARËT E TYRE

Qendrat informuese janë zakonisht qendra jo-rezidenciale, në përberje të të cilave punësohen persona me dhe jo me aftësi të kufizuara. Pikësynimi kryesor është të ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara të arrijnë potencialin e tyre maksimal në gjirin e familjes dhe komunitetit. Gjithashtu ato janë edhe qendra avokatie për çështje të rëndësishme në nivel lokal dhe kombëtar. Qendrat e informimit ofrojnë informacion në lidhje me aksesin në strehim, punësim, transport, aktivitete shlodhëse, si dhe aksesin në shërbimet sociale e shëndetësore. Qendra mund të ofrojë informacion mbi operatorët publikë apo privatë që ofrojnë shërbime shoqërore apo shërbime të tjera ndihmëse në funksion të personave me aftësi të kufizuara në nivel Bashkie. Qendra mund të marrë edhe rolin e ndërmjetësuesit-ndihmuesit midis ofruesve të shërbimeve shoqërore dhe personave me aftësi të kufizuar-familjarëve të tyre për sigurimin e shërbimeve shoqërore në përputhje me nevojat që ata paraqesin. Nga ana tjetër, qendra do të shërbente më së miri si një pikë identifikuese dhe vlerësuese e nevojave të personave me aftësi të kufizuara pranë çdo bashkie.



SHËRBIMI I NDËRHYRJES PËR FËMIJËRINË E HERSHME

Shërbimi i ndërhyrjes për fëmijërinë e hershme ofron mundësi të ndryshme shërbimesh për fëmijët parashkollorë që janë në rrezik për të zhvilluar aftësi të kufizuar apo kanë lindur me aftësi të kufizuar fizike, mendore, shqisore etj. Kjo do të kërkonte caktimin e një stafi koordinues që punon së pari me familjen në bazë të një plani multidisiplinar duke patur në qendër fëmijën. Programet terapeutike të ndërhyrjes dhe trajtimit të vështirësive që shfaq fëmija përgjatë viteve të para të fëmijërisë janë të larmishme. Ato i përgjigjen nevojave të fëmijës dhe janë të planifikuara për t'u implementuar në ambiente dhe mjedise natyrale aty ku fëmija rritet dhe zhvillohet, siç janë: familja, institucionet e edukimit të hershëm, dhe programi në mjedise terapeutike siç është shërbimi në qendër që implementohet nën kujdesin e specialistëve të ekipit multidisiplinar duke patur në qendër fëmijën. Çdo etapë kohore kërkon ndërhyrje të ndryshme sipas moshës dhe aftësive të fëmijës. Programet e trajtimit i përgjigjen nevojave duke filluar nga ato më të lehtat deri tek ato të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e jetës së fëmijës. Shërbimet e ndërhyrjes së hershme që ofrohen në ambientet e qendrës përfshijnë: vlerësim psikosocial të fëmijës me ekip multidisiplinar, konsulta, terapi të specializuara në bazë të nevojave të fëmijës, si: terapi zhvillimi, terapi logopedike, terapi në dhomë sensoriale, terapi grupi, mbështetje për prindin nga psikolog, terapi familje, program mbështetës për fëmijën në institucionet e edukimit të hershëm, program mbështetës në familje dhe trajnim i prindit si të punojë në familje.



SHËRBIME TERAPEUTIKE

Shërbimet e specializuara terapeutike janë shërbime të cilat ofrohen në mënyrë të specializuar në qendër nëpërmjet terapive të ndryshme ose në mjediset e shtëpisë së përfituesit. Shërbimi i specializuar përfshin terapi si: fizioterapi/psikomotricitet, terapi zhvillimi, terapi logopedike dhe terapi të sjelljes. Ky shërbim është me bazë sesioni terapeutik. Përfituesit pranë qendrës mund të referohen nga profesionistë të tjerë, nga prindër të fëmijëve që marrin sakaq shërbim etj. Pranë qendrës ekipi multidisiplinar përbëhet nga: mjek psikiatër fëmijësh dhe adoleshentësh, mjek neurolog, psikolog klinik, logoped, fizioterapist dhe psikolog për vlerësimin dhe përmirësimin e dinamikave familjare. Ky ekip ofron vlerësimin fillestar të rastit dhe hartimin e planit të ndërhyrjes së rastit për një periudhë të caktuar kohore [9 mujore ose 1 vjeçare]. Gjithashtu, ekipi ofron edhe konsulta të herëpashershme me familjet e fëmijëve përfitues të shërbimit si dhe psikologu për vlerësimin dhe përmirësimin e dinamikave familjare ofron sesione këshillimi individual dhe/ose në grup për prindërit. Ekipi multidisiplinar ofron gjithashtu rivlerësimin e fëmijës çdo vit.


SHËRBIME TË Pjesëmarrjes NË KOMUNITET

Këto shërbime, do të krijojnë mundësinë e pjesëmarrjes në jetën e komunitetit për individë me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për mbështetje dhe mbikqyrje të vazhdueshme. Aktivitetet do të përfshijnë programe zbavitese dhe çlodhjeje, aktivizimin politik (si pjesëmarrje në shoqata, etj.) si edhe punë vullnetare. Shërbimet e pjesëmarrjes në komunitet i japin mundësinë individëve të ndjehen të integruar, ndërsa komunitetit i japin mundësinë të shohë të gjithë diversitetin e tij, duke kontribuar kështu në zhvillimin e frymës së mirëkuptimit dhe tolerancës. Individu me aftësi të kufizuara merr pjesë në aktivitete të shoqëruar nga një asistent personal.



SHËRBIMI I ASISTENCËS NË SHTËPI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Është një shërbim i domosdoshëm i cili synon në lehtësimin e familjes dhe rritjen e shkallës së independencës e të pjesëmarrjes së individit me aftësi të kufizuara. Me shërbimet në shtëpi nënkuptohet që një njësi lëvizëse do të krijohet dhe do të pajiset me aftësi dhe infrastrukturë të nevojshme (automjet, materiale ndihmë) për të ofruar shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuar në familje. Kjo njësi lëvizëse do të përbëhet nga një ekip profesionistësh: punonjës socialë, psikologë, fizioterapist dhe logopedist. Ekipi do të vlerësojë nevojat e fëmijës dhe familjes dhe do të zhvillojë një Plan Zhvillimi Individual (PZHI) dhe do të kryejë vizita/terapi në familje sipas planit të përcaktuar në PZHI. Ky ekip specialistësh në të njëjtën kohë do të mbështesë anëtarët e familjes/kujdestarët duke synuar aftësimin e tyre në realizimin e aktiviteteve që ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e tyre.



QENDRA DITORE MULTIFUNKSIONALE

Qendra ditore multifunktionale janë një domosdoshmëri për çdo bashki. Qendra, duhet të jetë një derë e hapur për persona me aftësi të kufizuara kryesisht intelektuale, të cilët kanë përfunduar ciklin e arsimit apo nuk kanë mundësi të integrohen në të. Në varësi të nevojave të klientit, qendra ofron terapi fizike e okupacionale për disa orë në ditë. Shërbimi i ofruar duhet të ndihmojë në rehabilitimin e integrimin e personave me aftësi të kufizuara, por të jetë edhe një lehtësi për prindërit e familjarët e tyre, të cilët mund të punësohen apo kryejnë aktivitete të cilat i kanë humbur për shkak të shërbimit 24 orë të tij/saj, ndaj familjarit me aftësi të kufizuara.

¹ Ligji nr. 93/2014, Dt. 28.07.2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara"
² Ligji Nr.121, datë 21.11.2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
³ Plani Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, VKM nr. 276, datë 12 maj 2021
⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 380, datë 5.6.2019 "Për miratimin e dokumentit politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatimin e tij"
⁵ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 87, datë 3.2.2016 Për miratimin e Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2016-2020 /VKM Nr. 1071, datë 23.12. 2015 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të të Mbrojtjes Sociale 2015-2010
⁶ Ligji Nr.121, datë 21.11.2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë".